
RAPORT I DEBATIT

***KULTURA,
ARTI DHE ZHVILLIMI
EKONOMIK***

Qershor 2014, Prishtinë



**FORUMI
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura

Rrjeti i organizatave të pavarura të
kulturës të Kosovës

www.forumikulturor.net



**FORUMI
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës
www.forumikulturor.net

Prodhimi i këtij dokumenti është mundësuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe Olof Palme International Center e mbështetur nga Qeveria Suedeze.

“Ky publikim u prodhua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Forumit Kulturor dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet mendimet e Bashkimit Evropian dhe Olof Palme International Center”

RAPORT I DEBATIT

KULTURA, ARTI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



SWEDEN

Përmbajtja

Hyrje.....	6
Përkufizimet dhe çështjet metodologjike.....	8
<i>Arti dhe politika publike.....</i>	<i>11</i>
<i>Arti dhe rritja e zhvillimit ekonomik.....</i>	<i>13</i>
<i>Teoria e re e rritjes.....</i>	<i>17</i>
<i>Arti dhe ndikimi i tij.....</i>	<i>23</i>
<i>Arti dhe kultura si instrument.....</i>	<i>27</i>
<i>Arti dhe zhvillimi ekonomik në kontekstin e Kosovës..</i>	<i>30</i>
<i>Çështjet mundshme të tjera për artin në Kosovë.....</i>	<i>35</i>
Përfundim.....	37
Punimet e cituara.....	39

Hyrje

Arti dhe ekonomia tradicionalisht nuk kanë qenë fusha që shkojnë krah për krah me njëra-tjetrën. Arti nuk ka qenë shumë i interesuar për ekonominë, ndërsa ekonomia e ka parë artin si jashtë fushëveprimit të saj. Deri në vitet e 1960-ta, shumë pak është bërë që këto dy lëmi të ndërlidhen, por duke filluar nga vitet e 1980-ta ka pasur një lulëzim të literaturës në fushën e hulumtimeve dhe argumenteve që ndërlidhin këto të dyja, zakonisht në aspektin pozitiv. Pra, duke treguar se arti luan rol pozitiv në zhvillimin ekonomik. Megjithatë, përkundër literaturës së shumtë, ekonomia në përgjithësi vazhdojë të shpërfillojë artin dhe potencialin e tij për t'i dhënë kontribut ekonomisë. Shumica e arsyeve për shpërfilljen e artit kishin të bënin me mungesën e studimeve empirike, derisa pjesa më e madhe e literaturës përqendrohej në argumente, modele dhe të dhëna cilësore për mbështetjen e premises së tyre.

Gjatë kësaj kohe, arti zakonisht

shihej si diçka që njerëzit e bëjnë në kohën e lirë. Nganjëherë arti nuk dallohej nga zbavitja e thjeshtë. Si rrjedhojë e kësaj, për artin janë ndarë mjete të pakta financiare dhe kryesisht gjendej në pjesën e poshtme të prioriteteve në agjendat e politikëbërësve. Për më tepër, në kohën e krizave dhe masave shtrënguese ekonomike, fondet për artin kanë qenë të parat në listën e heqjes. Megjithëkëtë, ashtu siç tregon edhe hulumtimi i fundit, arti ka ndikim domethënës pozitiv në zhvillimin ekonomik. Posaçërisht tani kur struktura ekonomike është duke u deindustrializuar – pra, që është duke bartur bazën e saj nga prodhimtaria në shërbime apo në prodhimtari me specializim të lartë – ndikimi i artit po bëhet çdo ditë e më i dukshëm, ku në të ardhmen do të luajë rol edhe më të rëndësishëm.

Kosova në këtë aspekt nuk dallon. Në fakt, për shkak se Kosova është vend në zhvillim, mendimi se arti është i parëndësishëm për zhvil-

limin ekonomik rrënjësohet edhe më thellë për shkak se ekzistojnë kaq shumë fusha të tjera ku ka nevojë për investime. Hulumtimi praktik tregon se Kosova shpenzon për kulturën shumë simbolike prej 0.8 për qind nga buxheti i saj i përgjithshëm shtetëror (Pozhegu, 2014). Po ky hulumtim tregon se pjesa më e madhe e këtij buxheti shkon në infrastrukturë, duke ilustruar kështu në mënyrë të përkryer mendësinë shpërfillëse se është infrastruktura ajo që ka nevojë për investime dhe jo kultura si e tillë. Nga ana tjetër, shumë pak studime dhe hulumtime janë bërë në fushën e kulturës, të cilat do të tregojnë raportin e artit me ekonominë në kontekstin e Kosovës. Në fakt, kjo mungesë e hulumtimeve nuk është befasisëse, duke ditur mungesën e të dhënave, gjë që e bënë të pamundur kryerjen e një studimi gjithëpërfshirës. Së këndejmi, pjesa më e madhe e këtij hulumtimi është bazuar në të dhënat e brendshme të organizatave apo në

intervista me palët kryesore me interes.

Përmes këtij raporti për politika tentohet të bashkohen hulumtimet dhe studimet e bëra në këtë fushë nga mbarë bota në mënyrë që të tregohet se si arti ndikon në zhvillimin ekonomik. Duke marrë parasysh mënyra të shumta dhe komplekse, përmes të cilave arti ndërvepron me ekonominë, në kuadër të këtij raporti të politikave do të paraqiten mekanizmat kryesorë që tregojnë se si ndodh ky proces dhe, aty ku është e mundur, do të paraqiten edhe dëshmi empirike. Në pjesën e dytë të raportit, do të riinterpretohet sektori i kulturës në Kosovë dhe konteksti i tij në dritën e hulumtimit të paraqitur. Një kontekstualizim i tillë do të ketë për qëllim zbatimin e hulumtimit për Kosovë dhe paraqitjen e mundësive të mundshme të hulumtimit në të ardhmen.

Përkufizimet dhe çështjet metodologjike

Një nga çështjet e rëndësishme në studimin se si arti dhe kultura ndikojnë ekonominë dhe shoqërinë në përgjithësi, janë edhe vetë përkufizimet e shprehjeve dhe fjalëve të përdorura. Pra, çka është arti dhe kultura? Njeriu zakonisht e ndërlidh kulturën me ekspozita të artit dhe galeri, skulpturë, muze, teatër dhe mundësisht me koncerte simfonike ose opera. Megjithatë, arti përfshinë shumë më tepër se kaq. Pyetja shtrohet se deri ku mund të jetë limiti i këtij përkufizimi. Në këtë kuptim, lind pyetja se a mund të konsiderohen filmat si një e mirë apo mall kulturor? Apo ndoshta muzika? Letërsia? Natyrisht se ato janë. Mirëpo, nëse i krahasojmë, një film dallon shumë prej një pikturë, e cila nga ana tjetër dallon prej një kënge; ku kënga është krejt diçka tjetër në krahasim me librin, i cili prapë ka dallim me filmin. Përveç kësaj, dikush mund të argumenton se madje edhe brenda këtyre kategorive të gjëra ekzistojnë

dallimet. Një simfoni e Mocartit natyrisht se dallon nga një këngë e Xhustin Biberit (JustinBieber). Për më tepër, a duhet të konsiderohen reklamat si një e mirë kulturore? Apo dizajni industrial? Natyrisht, për të krijuar një reklamë nevojiten shkathtësi krijuese dhe për ndonjë dizajnues kjo mund të jetë shumë personale, mirëpo reklamat dallojnë shumë prej pjesës tjetër të arteve. Ngjashëm me këtë, a duhet të konsiderohet artistike dhe e mirë kulturore një pikturë e prodhuar në mënyrë serike dhe e shitur në vetëshërbim? Përgjigjet në të gjitha këto pyetje kanë qenë të ndryshme nga dijetarë e humlumtues të ndryshëm, duke e bërë kështu edhe më të vështirë studimin e ndikimit të artit në ekonomi dhe shoqëri në përgjithësi.

Nëse në këtë raport të politikave marrin parasysh shumë studime, mund të vijmë në përfundim se është tentuar të bëhet dallimi përmes këtyre tri koncepteve: “industrive kreative”, “industrive

kulturore” dhe “sektorit të kulturës”. “Industritë kreative” zakonisht përkufizohen si industri që mund të ndikohen nga arti dhe që zakonisht përdorin inpute të njëjta me artin, por që nuk prodhojnë art, siç janë dizajni i modës, agjencitë reklamuese, dizajni komercial dhe industrial, etj. Përmes “industrisë kulturore” mendohet në artin e pavarur në treg që është shndërruar në industri, siç është industria e filmit, e muzikës, etj. Ndërsa “sektori i kulturës” përkufizohet si sektor që zakonisht është më i vogël, është më personal dhe që ka tendencë të jetë më pak kundërthënës lidhur me përkufizimin e artit, siç janë galeritë, teatrot, artizanatet, muzetë, etj. Megjithatë, këto përkufizime mbesin të hapura.

Edhe pas përkufizimit të fushave prapë mbetet çështje e madhe se si mund të maten efektet e këtyre sektorëve. Njëra ndër çështjet imediate është se një pjesë e madhe e artit krijohet privatisht apo

jashtë “sistemit” dhe nuk paraqitet në asnjërin prej treguesve, siç janë regjistrat tatimorë apo ata të biznesit. Për t’i bërë gjërat më të lehta, kjo pjesë zakonisht kalohet në tërësi. Çështja tjetër është fakti se shumë nga organizatat artistike janë të regjistruara si organizata jofitimprurëse, ndërsa të tjerat si biznese. Disa nga organizatat janë shumë të vogla për plotësimin e dokumentacionit tatimor dhe si rrjedhojë nuk figurojnë në të dhënat tatimore (të hyrat, kontributet tatimore, punësimi, etj.). Duke marrë parasysh këtë dallim, dalin të dhënat të ndryshme për të dy “sektorët”, duke e bërë të vështirë sintetizimin e tyre. Për më tepër, dallimi mes organizatave jofitimprurëse dhe bizneseve kishte implikime të tjera kur kemi të bëjmë me debate rreth fondeve dhe efektit të tyre në ekonomi. Për shembull, një galeri jofitimprurëse dhe një fitimprurëse mund të ekspozojnë sjellje të ndryshme dhe, rrjedhimisht, të kenë efekt të ndryshëm në shoqëri.

Po ashtu, ndryshoret për llogaritjen e këtyre efekteve mund të dallojnë.

Dhe në fund, edhe pasi të jenë bërë të gjitha këto ndarje, prapë mbetet shumë vështirë të matet efekti i tyre në ekonomi për shkak të mungesës së të dhënave. Përkundër faktit se po jetojmë në kohën e revolucionit të të dhënave, të dhënat e hollësishme për artin dhe, çka është më e rëndësishme, për efektin e tij, zakonisht nuk janë konsekuente apo fare mungojnë. Edhe po qe se të dhënat do të ekzistonin, kërkohet metodologji e detajizuar dhe e thukët në matjen e të gjitha efekteve të artit. Të gjitha këto arsye kanë qenë pengesë për realizmin e studimeve të hollësishme dhe empirike në këtë fushë. 1

1 Përhollësitëtjërarrëthpërkufizimeved-hemënyrëssësiatondikojnëmodeletdhepolitikat e mundshmekulturore, lutenitëshihniDavid Throsby “Modelling the Cultural Industries”

Arti dhe politika publike

Çështja kryesore që trajtohet në këtë dokument të politikave është arsyeja pse politika publike duhet të merret me artin? Cilat janë dobitë publike të artit që mund të arsyetonin vëmendjen dhe financimet e komunës apo të qeverisë? Një njërin skaj kemi mendimin që plotësisht privatizon artin dhe argumenton që politika publike fare nuk duhet të jetë e përfshirë në art dhe se çdo gjë duhet t'i lihet tregut. Me fjalë të tjera, nëse ka mundësi për fitim, atëherë arti do të jetë i pranishëm në treg; nëse për individë të caktuar arti ka rëndësi, atëherë ata do të mund të kalonin kohën e lirë duke u marrë me të. Thënë ndryshe, përfitimet publike prej artit janë të pakta apo nuk ka fare dhe se si i tillë arti nuk meriton vëmendjen e politikave publike. Kjo pikëpamje nuk ka qenë e përhapur, mirëpo ka qenë e pranishme dhe nganjëherë edhe ndikuese.

Një pikëpamje tjetër argumenton se arti ngërthen në vete dobi

publike dhe se duhet të ketë në dispozicion financime publike në mënyrë që arti, siç është muzika klasike, opera, artet pamore, etj, të mund të ofrohet. Ky argument bazohet në idenë e dështimit të mundshëm të tregut. Nëse vetëm tregu do të vendoste se a duhet të prodhohen këto të mira kulturore, atëherë vendimi me siguri do të ishte negativ për shkak të kostos së lartë dhe kërkesës së ulët, kështu që këto të mira kulturore nuk do të ishin në dispozicion. Megjithatë, dobitë nga konsumi i këtyre të mirave kulturore janë si private, ashtu edhe publike, kështu që kërkesa e shoqërisë për këto të mira është më e lartë se kërkesa e përgjithshme individuale, duke rezultuar kështu në dështimin e tregut. Në këtë rast, nëse ky proces i lihet tregut do të prodhoheshin më pak të mira kulturore sesa që do të ishte optimumi shoqëror. Nga ana tjetër, vetë fakti se këto të mira kulturore janë në dispozicion dhe njerëzit mund t'u gëzohen

atyre paraqet një dobi publike; ndërsa disa individë edhe mund të krenohen se qyteti i tyre është qendër kulturore dhe ka ngjarje të shumta kulturore (Rushton, 2004). Këto të mira kulturore gjithashtu mund të jetë publike, siç janë muzetë apo skulpturat publike, që nuk do të mund të ofroreshin nga tregu; duke dhënë kështu arsytim për ndarjen e resurseve nga ana e qeverisë. Një arsytim tjetër për përfshirjen e sektorit publik në sektorin e kulturës mund të jenë mundësimi i pjesëmarrjes në ngjarje kulturore për çdokënd, madje edhe për të varfrit, të cilët përndryshe nuk do të mund t'i shijonin ato (Rushton, 2013). Kjo bazohet në supozimin se arti është pjesë e plotësimit të jetës dhe duhet të jetë në dispozicion për çdokënd. Kjo pikëpamje ka ngjashmëri mjaft të madhe me të parën, në kuptimin që sipas të dyjave arti shihet vetëm si një e mirë konsumuese, mundësisht një e mirë e veçantë konsumuese, e cila nuk kufizo-

het në konsumin individual, duke dhënë kështu arsytim për ndërrhyrje të sektorit publik.

Për dallim nga dy pikëpamjet e shprehura më lartë, një qasje tjetër thekson rolin e artit në formësimin e shoqërisë dhe të individëve të saj. Kjo pikëpamje shprehet nga pjesëtarët e komunitetit, të cilët argumentojnë se në shoqëri demokratike ka nevojë për standard të njohur përgjithësisht të jetës së mirë (Rushton, 2004) dhe se arti është mekanizëm thelbësor në formësimin e këtij standardi. Duhet të ceket se kjo pikëpamje dukshëm dallon nga dy të tjerat për shkak se jep një arsytim tjetër nga ai i konsumit individual apo preferencave individuale, si dhe dallon nga perspektiva e ardhshme që do të paraqitet, përmes se cilës theksohen aspektet e jashtme pozitive të artit.

Arti dhe rritja e zhvillimit ekonomik

Pikëpamjet e cekura më lartë janë vështrime më tradicionale të ekonomistëve për artin dhe në përgjithësi ofrojnë arsytim për financimin publik. Megjithatë, që të tri pikëpamjet kanë problemet e veta, të cilat nuk janë vështirë të shihen. Pikëpamja e parë në thelb e sheh artin si pak më shumë se një zbatimje, për të cilën politikat publike nuk duhet të kenë interes. Pikëpamja e dytë thekson aspektet e konsumit të artit, por nuk e sheh atë si një motor të mundshëm të zhvillimit ose si një aktivitet produktiv; kështu që arti bëhet një ngarkesë buxhetore dhe thithëfondet nga projektet e tjera të rëndësishme që nxisin rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ndërsa pikëpamja e tretë paraqet sfidat ndaj normave liberale, të cilat janë kundër ndërhyrjes së shtetit në çështje individuale. Andaj, i kthehemi pyetjes se pse politika publike duhet të merret me artin?

Kohëve të fundit hulumtues dhe organizata të shumta janë përp-

jekur ta tërheqin vëmendjen tek kontributi gjithnjë në rritje i artit dhe i industrive kreative në ekonomi. Ky kontribut në rritje, sipas tyre, jep arsytimin për përfshirjen e shtetit në art. Në vitin 2010 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, arti dhe kultura kanë kontribuar në BPV me neto eksporte në shumën prej 41 miliardë\$ (64 miliardë\$ në eksporte minus 23 miliardë\$ në importe) ose 2.82 % të BPV-së (Marquis, 2013). Në BE, ekonomia e kulturës dhe e kreativitetit kanë kontribuar me rreth 3% në BPV-në e BE-së, më shumë se industria kimike, e cila kontribuoj me 2.3% dhe industria e ushqimit me 1.9% (Cooke & De Propriis, 2011). Në Mbretërinë e Bashkuar industritë kreative janë duke u zhvilluar më shpejtë se sektorët e tjerë. Mes viteve 1997 dhe 2007, industritë kreative mesatarisht u rritën për 5% në vit – shumë më tepër se pjesa tjetër e ekonomisë, e cila u rritë për 3% në vit gjatë periudhës së njëjtë (De-

partamenti i kulturës, medias dhe sportit, 2010).

Nëmënyrë të ngjashme, humtuesit dhe organizatat gjithashtu kanë theksuar ndikimin ekonomik të artit, duke i matur efektet e drejtpërdrejta ekonomike të një ngjarjeje të caktuar kulturore apo të organizatës. Kjo metodështë bërë mjaft e popullarizuar kohëve të fundit, pasi që të dhënat llogariten lehtë dhe rezultatet janë të kapshme. Për shembull, nënjëraport të hollësishëm të organizatës Americanfor the Arts (2013) përmbliidhen rezultatet e ndikimit ekonomik të organizatave të kulturës (organizatave jofitimprurëse të artit dhe industrisë së kulturës) në 182 regjione nga të gjitha 50 shtetet e ShBA-ve gjatë vitit 2010, ku tregohet ndikimi i drejtpërdrejtë ekonomik i artit, i cili arrinë shumën prej 135.20 miliardë\$. Përveç ndikimit të drejtpërdrejtë ekonomik, organizatat dhe industritë e kulturës gjithashtu kontribuojnë me rreth 22.33 mil-

iardë\$ në tatime, nga të cilat 6.07 miliardë\$ shkojnë drejtpërdrejtë tek pushteti lokal (që dallon nga niveli shtetëror dhe ai federal). Përpos tatimeve dhe përfitimeve të drejtpërdrejta, organizatat dhe industritë e kulturës gjithashtu kontribuojnë në krijimin e vendeve të reja të punës: gjatë të njëjtit vitit këto organizata kanë krijuar 4.13 milionë vende të reja të punës me orar të plotë. Nëse e masim vetëm sektorin e organizatave jofitimprurëse dhe atë të kulturës (duke mos përfshirë industrinë e kulturës), përqindja e vendeve të krijuara të punës ka qenë më e lartë se ajo e kontabilistëve, auditorëve, policëve, juristëve dhe avokatëve, menaxherëve financiarë dhe programuesve kompjuterikë.

Teoria e eksportit gjithashtu thotë se arti dhe kultura mund të kontribuojnë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik pasi që edhe ato mund të eksportojnë mallrat dhe shërbimet e tyre. Kjo teori e konsideron artin sikurse çdo mall dhe shërbim

tjetër në treg që mund të tregtohet, dhe pasi që të jetë tregtuar mund të ndihmojë në bilancin e pagesave dhe deficitin tregtar. Më fjalë të tjera, njëqytet mund të jetë i suksesshëm në prodhimin e pikturave, të cilat i pëlqejnë qytetet e tjera tëbotës dhe, rrjedhimisht, ky qytet eksporton, dhe me paratë e fituara nga eksporti mund të investojë apo të konsumojë më shumë mallra, duke u rritur kështu ekonomikisht. Suksesi kryesor në këtë aspekt është shtytja që i jepet turizmit. Duke marrë parasysh se një numër i madh turistësh vizitohet ngjarjet kulturore dhe kënaqen me artin lokal, atëherë mund të argumentojmë se arti “eksporton” produktet e veta tek njerëzit jashtë regjionit. Në fakt, turizmi dhe arti janë ngushtë të ndërlidhur dhe kjo ndodh për arsye të qarta. Përveç resurseve natyrore, shumë turistë zgjedhin vendet e tyre të pushimit edhe për shkak të ofertës së tyre kulturore. Për shembull, shteti Juta i ShBA-ve vizitohet edhe deri

nga 45000 vizitorë nga mbarë bota gjatë festivalit të përvitshëm Sundance Film Festival(The National Governors Association , 2012). Përveç turizmit dhe shpenzimeve të tyre, vizitorët që përfshijnë ngjarjet kulturore në udhëtimet e tyre duket se dallojnë nga vizitorët e ‘rregullt’. Një studim i Shoqatës së Sektorit tëUdhëtimeve (TravelIndustryAssociation)(2003)tregon se vizitorët që përfshijnë ngjarjet kulturore shpenzojnë më shumë se vizitorët e tjerë. Këta vizitorët kanë tendenca të udhëtimeve më të gjata se sa vizitorët e tjerë, kalojnë më shumë netë në qytet dhe gjasat që të shpenzojnë 1000\$ apo më shumë gjatë qëndrimit të tyre janë më të mëdha. Rreth dy të tretat e vizitorëve amerikanë thonë se në udhëtimet e tyre kanë përfshirë aktivitete apo ngjarje kulturore, artistike, të trashëgimisë apo historike në një udhëtim prej 80 km apo më të gjatë, ndërsa një e treta e këtij grupi thonë se kanë kaluar më shumë kohë në udhëtimin e

tyre si rezultat i ndonjë ngjarjeje kulturore.

Është e vërtetë se kultura dukshëm kontribuon në turizëm. Mirëpo, çka ndodh në qytete ose shtete ku vajtje-ardhjet e turistëve janë të pakta ose të papërfillshme? Çka ndodh në qytete ku nuk ka eksport të artit? A duhet që qeveria ta humb interesimin e saj dhe të kthej përqendrimin tek projektet e që janë më profitabile ekonomikisht? Edhe në rastet kur kemi një ‘bazë eksporti’ për arte, sa e madhe është ajo në krahasim me sektorët e tjerë? Në përgjithësi, në këtë aspekt, arti nuk mund të krahasohet me sektorët të tjerë të ekonomisë, kështu që ndikimi i tij në ekonomi është i kufizuar. Sido që të jetë, teoria e bazës së eksportit ngërthen në vete çështje të rëndësishme. ÇarllsTibo (Charles-Tiebout) në mënyrë të shkëlqyer paraqet paradoksin e teorisë së eksport-importit, duke i hequr kufijtë e qyteteve dhe shteteve. Ai argumenton se po qe se do ta shikonim

botën si një njësi, ajo nuk eksporton, por rritet sipas Markusen dhe të tjerëve (Markusen, et al., 2013). Argumenti i tij shkon në përputhje me mendimin e AdamSmithit (AdamSmith), që rritja vjen nga ndarja e brendshme e kontributeve të punës në rritje dhe vetëm pasi që puna të jetë caktuar dhe specializuar tregtia mund të vazhdojë. Në këtë mënyrë, është rritja e ‘prodhimit të artit’ ajo që çon në eksport e jo e kundërta. Ky mendim është integruar në pjesën më të madhe të mendimeve ekonomike, ku insistohet që ndërmarrjet dhe sektorët eksportues të jenë të privilegjuar gjatë hartimit të politikave publike. Kontributin relativisht i vogël i artit në këtë aspekt dhe mosinteresimi i qeverive për të, kryesisht vjen për shkak të kësaj forme të të menduarit (Markusen, et al., 2013).

Teoria e re e rritjes

Të gjitha pikëpamjet e paraqitura deri më tani japin argumente relativisht të dobëta se pse politikëbërësit duhet të merren me artin. Teoria e bazës së eksportit jep disa argumente për atë se si arti do të mund t'i kontribuonte rritjes ekonomike, ndërsa pikëpamjet e tjera fare nuk merren me rritjen. Megjithëkëtë, arti mund t'i kontribuoj rritjes dhe zhvillimit ekonomik. Në dekadën e fundit, teoria e re e rritjes ekonomike apo siç quhet nganjëherë edhe teoria endogjene e rritjes proklamonte se arti dukshëm kontribuon në rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Organizata American for the Arts paraqet këtë listë të arsyeve për atë se si do të mund të kontribuonte arti në vitalitetin e ekonomisë dhe në zhvillimin ekonomik (siç është përmbledhur në Marquis, 2013):

- Estetika: Arti krijon bukurinë dhe e ruan atë si pjesë të kulturës.
- Kreativiteti: Arti inkurajon kreativitetin si një shkathtësi thelbësore

në botën dinamike.

- Shprehja: Puna artistike na mundëson komunikimin e intereseve dhe vizioneve tona.
- Inovacioni: Arti është burim i ideve, koncepteve dhe lidhjeve të reja.
- Ruajtja: Arti dhe kultura ruajnë mbamendjen tonë kolektive.
- Prosperiteti: përmes artit krijohen miliona vende të reja të punës dhe përmirësohet shëndeti ekonomik.
- Shkathtësitë: Aftësitë dhe teknikat e artit janë të nevojshme në të gjithë sektorët e shoqërisë dhe të punës.
- Kapitali shoqëror: Ne të gjithë i gëzohemi artit pa dallim race, brezash dhe vendesh.

Rushton(2013)nga ana tjetër thekson tri pika se si do të mund të funksiononte teoria e re e rritjes ekonomike. Së pari, duke përm-

bledhur punën e ekonomistëve të tjerë që janë marrë me aspektin e rritjes dhe zhvillimit ekonomik, ai argumenton se në ekonomitë e përparuara, është ndryshimi teknologjik dhe jo teknologjia e tanishme ai që dikton rritjen ekonomike. Kjo pikë është shumë e ngjashme me konceptin e Shumpeterit (Schumpeter) për “shkatërrimin kreativ”, i cili i referohet inovacionit dhe shkatërrimit të vazhdueshëm (gjegjësisht, heqjes nga tregu) të produkteve të vjetra dhe zëvendësimittë tyre me të reja që janë më inovative. Arti ndërlidhet me këtë koncept të ndryshimit teknologjik në kuptimin që arti vazhdimisht krijon dhe sjell në pah ide të reja, të cilat më pas përhapen në sektorë të tjerë të ekonomisë. Së dyti, ekzistojnë përhapje të shumta dijes të kompanive që gjenden afër njëra-tjetrës me rastin e zhvillimit të ideve të reja. Thënë ndryshe, me rastin e zbatimit të një ideje të re nga një kompani, kompania tjetër

mund të përfitojë, duke mësuar nga ajo. Kjo është njëra prej arsyeve pse kompanitë, posaçërisht ato nga industria e dijes, gjenden afër njëra-tjetrës, duke formuar kështu të ashtuquajturit “kllasterë”. Dhe e treta, në krahasim me inputet e tjera, teknologjia dhe puna, dija dhe inovacioni nuk ballafaqohen me kthim në rënie të vlerës. Me fjalë të tjera, derisa 50 makina të qepjes mund të jenë shumë për prodhimin e 100 palë rrobash, 50 ide për stilin e veshjes apo të prodhimit asnjëherë nuk janë të tepërta.

Markusen et al. (2013), përveç mekanizimit të përmbledhur nga Rushton, gjithashtu sugjerojnë alternativën e ‘bazës konsumuese’. Së pari, ata argumentojnë se ndryshimet në modelin regjional të konsumit për shkak të ndryshimeve në shije dhe preferenca në favor të prodhimeve vendore mund të rrisin punësimin dhe vlerën e shtuar pa zgjerim të bazës së eksportit. Ata argumentojnë se

ky koncept është më i gjerë se ai i zëvendësimit të importit, përmes të cilit tentohet zëvendësimi i mallrave të importuara me mallrat vendore. Rritja e kërkesës për mallrat vendore mund të ndodh kur qytetarët ndryshojnë konsumin e tyre dhe orientohen në produkte e shërbime të reja që vihen në dispozicion në ekonomi, siç është teatri, muzika dhe artet e tjera. Si rrjedhojë e kësaj, punësimi lokal rritet edhe më shumë për shkak të konsumit të tërthortë dhe efektit të multiplikatorit. Kjo posaçërisht vlen për artin, që kërkon fuqi punëtore. Pothuajse gjysma e shpenzimeve për organizatat e kulturës në ShBA shkojnë në fuqi punëtore (Americans for the Arts, 2013). Për më tepër, artistët ka më shumë gjasa të harxhojnë të ardhurat e tyre në vend, duke rritur kështu multiplikatorin. Përveç shpenzimit, konsumi lokal po ashtu mund të inkurajoj inovacionin. Kjo ndodh për shkak të faktit se sektorët e ri të eksportit shpesh

testohen në tregun lokal para se të eksportohen. Dhe në fund, oferta lokale superiore e konsumit ndihmon në tërheqjen e punëtorëve të shkathët dhe të një “klase kreative”, të cilët do të kontribuonin edhe më shumë në zhvillimin ekonomik.

Nëse kemi disa mekanizma se si do të mund të funksiononte teoria e re e rritjes ekonomike dhe si do të mund të kontribuonte arti në zhvillimin dhe rritjen ekonomike, a mund të themi se zhvillimi i artit dhe kulturës në nivelin lokal ka efekt pozitiv në ekonominë e vendit? Kjo ishte pyetja që Pedroni dhe Sheppard (2013) e trajtuan në studimin e tyre empirik. Pikësëpari, ata paraqesin një grafik që tregon korrelacionin pozitiv mes BPV-së lokale për kokë banori dhe shpenzimeve lokale në kulturë për kokë banori, të cilin shumë hulumtues e kanë paraqitur si dëshmi të ndikimit pozitiv të artit në ekonomi. Megjithatë, ky argument del të jetë i gabueshëm sepse, ai raport është

pozitiv pothuajse për çdo sektor tjetër për shkak të faktit se sa më e pasur të jetë popullata, më shumë do të shpenzon në gati çdo gjë. Pas hedhjes poshtë të argumenteve të tilla, ata përdorin një model të thjeshtë konceptual, por të ndërlikuar matematikor, ku trajtohen resurset kulturore (prodhimin kulturor) sikurse të ishte kapital fizik – thënë ndryshe, kultura në këtë model funksionin ngjashëm me kapitalin fizik. Më pastaj ata fusin në përdorim të dhënat nga 384 zona të ShBA-ve. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të të dhënave, ata konstatojnë mundësinë e ekzistimit të lidhjes shkakore, ku rritja e prodhimit vendor të kulturës krijon rritje të përhershme të BPV-së vendore. Me fjalë të tjera, ata tregojnë se prodhimtaria e kulturës funksionin ngjashëm me kapitalin fizik – rritja e njërës çon në rritjen e përhershme të produktivitetit.

Duke kërkuar që t'i përgjigjen të njëjtës pyetje, Buçi dhe të tjerët (Bucci et al). (2014) ndërtojnë

modelin teorik se si mund të ndikojnë të mirat kulturore në zhvillimin ekonomik. Studime të shumta, të cilat akumulimin e kapitalit njerëzor ia atribuojnë rritjes dhe zhvillimit ekonomik shkojnë nëpër të njëjtën rrugë, edhe pse me një modifikim të vogël: përkufizimi i kapitalit njerëzor në këto studime shkon përtej “kapitalit të thjeshtë arsimor-edukativ” që është numri i viteve të shkollimit që ka fuqia punëtore në atë vend, duke përfshirë edhe kapitalin më të gjerë kulturor. Zgjerimi i përkufizimit të kapitalit njerëzor nuk nënkupton se arsimi nuk është i rëndësishëm, por merr parasysh faktin se shkathtësitë janë të nevojshme, por jo edhe të mjaftueshme për zhvillimin ekonomik. Vetëm shkathtësitë do të ndihmonin në zvogëlimin e kostos, megjithatë inovacioni ka nevojë për diçka më shumë se shkathtësitë – ka nevojë për kapital kulturor. Si rezultat i kësaj “kur konkurrenca nuk mund të zhvillohet përmes zvogëlimit

të kostove, inovacioni i produktit paraqet faktorin dallues të suksesit për sistemin ekonomik qoftë të regjionit apo të shtetit në tërësi, kështu që efekti i përhapjes i ardhur si rrjedhojë e qëndrimeve kreative të shoqërisë bëhet edhe më i rëndësishëm në shpjegimin e suksesit të rritjes ekonomike – apo edhe të dështimit” (Bucci, et al., 2014). Në përfundimet e tyre, ata argumentojnë se jo vetëm kapitali kulturor është faktor kyç në rritjen e vazhdueshme ekonomike, por se mungesa e tij mund të vë shtetet para rrezikut të dështimit.

Studime të tjera tregojnë rezultate të ngjashme. Markiz (Marquis) (2013) tregon teoretikisht se me rritjen e rëndësisë së kapitalit kulturor në procesin e prodhimit, rezultatet si në sektorët e kulturës, ashtu edhe në ata jashtë kulturës, rriten me shpejtësi. Megjithëse, kjo shkallë e rritjes, edhe pse domethënëse, nuk ka përhapje të gjerë. Arsyeja për këtë është se Markiz sheh dy veti të mallrave

apo të mirave kulturore: mallrat kulturore njëkohësisht janë mallra të konsumit dhe mallra kapitale dhe sa më shumë që konsumohen mallrat kulturore aq më i madh është vlerësimi i tyre, duke rritur kështu konsumin e tyre (nocioni i varësisë pozitive). Vetia e parë më së miri ilustron nga libri klasik i ViktorHygos (VictorHugo) Të mjerët. Fillimisht është shkruar si libër, shumë kohë më vonë është bërë edhe drama, ndërsa së fundi është xhiruar dhe filmi. Kështu, ky libër është mall konsumi në kuptimin që dikush mund ta lexon, por është edhe mall kapital në kuptimin që ishte kushtimisht të themi ‘lëndë e parë’ për dramën dhe filmin. Në përmbledhje të kësaj mund të themi se këta dy faktorë mjaftojnë për të krijuar rritje të përgjithshme të rezultateve ekonomike.

Studimi i fundit që do të diskutohet lidhur me ndikimin e artit në rritjen dhe zhvillimin ekonomik është studimi empirik i bërë nga

Pjergjovani dhe të tjerët (Piergiovanni et al.) (2012). Në kuadër të këtij studimi hulumtohet ndikimi i një numri faktorësh në rritjen ekonomike të 103 krahinave italiane gjatë periudhës kohore prej vitit 2001 deri më 2006. Për ta bërë këtë, ata realizuan një regresion të bazuar në modelin, përmes të cilit tentohet të shpjegohet ndryshimi në vlerën e shtuar regjionale të rritjes ekonomike dhe në rritjen e punësimit në bazë të faktorëve, siç janë: formacionet e reja të biznesit, ofrimi i shërbimeve, ndryshimi i numrit të markave tregtare dhe patentave, ardhja e imigrantëve, ndryshimet në kreativitetin e qytetit (që matet si ndryshim në numrin e kompanive në sektorin kreativ). E gjetura kryesore e studimit thekon ndikimin domethënës të shkallës së punësimit në regjion nga specializimi sektorial dhe nga shkalla e rritjes ekonomike të kompanive në industrinë kreative. Sipas intuitës, krijimi i bizneseve të reja gjithashtu luan rol në rritjen e punësimit,

megjithatë karakteristikat që kanë luajtur rol të rëndësishëm në të kaluarën, siç është prania e komplekseve apo parqeve industriale, kanë humbur funksionin e tyre të ofrimit të rritjes së punësimit. Të gjeturat në këtë studim sugjerojnë që industrinë kreative do të mund të krijojë rritje më të madhe të punësimit, duke kontribuar kështu më shumë në uljen e papunësisë se sa faktorët tjerë tradicionalë (komplekset industriale, energjia dhe minierat, etj).

Arti dhe ndikimi i tij

VallaValla (WallaWalla) është qytet i vogël me jo më shumë se 32000 banorë, i cili gjendet në jug të shtetit të Uashingtonit në ShBA. Më parë, ekonomia e tij bazohej në bujqësi, mirëpo zhvillimi ekonomik po binte dhe popullata e qytetit po zhvendosej. Gjatë kësaj kohe kryetari i një kolegji lokal doli me vizionin për të investuar në sektorin e verës, sektor i cili do ta qonte VallaVallën në shekullin 21. Kolegji e hapi institutin dhe më pas edhe Qendrën për Enologji dhe Vreshtari për të trajnuar njerëzit në prodhimin e verës. Kolegji ndihmoi në tërheqjen e ekspertëve të verës. Njëkohësisht, kryetari i kolegjit këtë aktivitet e përcolli me investime të tjera në fushën e artit dhe prodhimit të verës, duke krijuar një kulturë që nuk e konsideronte prodhimin e verës vetëm nga pikëpamja ekonomike. Si rezultat i kësaj pune, nga 19 vërsitari, sa ishin në vitin 1981, në vitin 2003 numri i tyre u rritë në 240. A ishte vetëm ideja e kryetarit të koleg-

jit përgjegjëse për suksesin apo edhe arti kishte ndikimin e vet? Në raport² thuhet se tëdyjat ndikuan.

Një nga kontributet më të rëndësishme të artit në ekonomi ka të bëjë me ndikimin pozitiv të artit në sektorë të tjerë. Mirëpo, ky proces është edhe më i vështiri për t'u matur dhe kërkon metodologji dhe të dhëna të ndërlikuara. Nuk është për t'u habitur se në këtë aspekt dëshmitë empirike janë të pakta. Për më tepër, mekanizmi i ndikimit mbetet i paqartë. Si ndihmon arti në produktivitetin e sektorëve të tjerë, nëse fare ndihmon? Tabela më poshtë, e krijuar nga CreativeSpin (2012), tregon rrugët e mundshme se si ky ndikim funksionon.

² Përmëshumëinformata, lutenitëshihniStuart Rosenfeld "The Art of Economic Development".

Lloji i ndikimit	Çka	Si	Dobitë e mundshme për sektorë të tjerë
Ndikimi i njohurive	Idetë e reja, know-how (për shembull, për procese dhe modele bashkëpunuese të veprimit) dhe teknologjitë e zhvilluara nga aktorë kreativ që kanë dobi për sektorë të tjerë	Punësimi i profesionistëve kreativë në sektorë të tjerë (qarkullimi i fuqisë punëtore	Produktiviteti, konkurrueshmëri dhe inovacione të rritura në sektorë të tjerë përmes zhvillimit të: <ul style="list-style-type: none"> - produkteve, shërbimeve apo instrumenteve të reja të marketingut. - mjedis i punës që nxitë kreativitetin dhe e inovacionin - Modele të reja organizative (më pak hierarkike dhe më shumë fleksibile) <ul style="list-style-type: none"> ▪ EDalja e kompanive të reja (ndikimi në ndërmarrësi) ▪ ImEfekshtëmëria e dëshmuar në sektorin/ shërbime publike dhe në modele të qeverisjes
		Bartje e heshtur e njohurive (për idetë e produkteve, menaxhimin e talenteve kreative, kulturën e inovacionit , instrumentet e marketingut, modelet qeverisjes, modelet, etj) në sektorë të tjerë përmes lidhjes B2B apo kontakteve të tjera	
		Profesionistët kreativ që hapin start-up-e në sektorë të tjerë	
		Kërkesa e sofistikuar nga CCI-të që nxitë produkte të reja në sektorë të tjerë (p.sh. informata të reja për softuer filma / rrjete të arteve)	
Ndikimi i produkteve dhe shërbimeve	Mallrat dhe shërbimet kreative që krijojnë dobi për sektorë të tjerë.	Firmat në industri të tjera zhvillojnë mallrat plotësuese (p.sh. .iPod)	Inovacion dhe produktivitet i rritur/ konkurrueshmëri në sektorë të tjerë përmes zhvillimit të produkteve apo shërbimeve plotësuese . <ul style="list-style-type: none"> ▪ Futja /mbajtja apo rritja e shitjes së teknologjive të reja falë atraktivitetit të përmbajtjeve.
		Firmat në industri të tjera përshtatin mallrat dhe shërbimet për krijimin e produkteve dhe shërbimeve të tjera (p.sh. dizajni i modës i aplikuar në sektorë të tjerë, siç janë ai aviokompanive dhe veturave, etj)	
Ndikimi i rrjeteve	Përparsitë që fitojnë firmat duke u bashkuar në grupe: <ul style="list-style-type: none"> - Tërheqja e individëve /krijimi i imazhit më tërheqës (ndikimi aglomerues) - Ndarja e ideve mes firmave (ndikimi i 	Skena kulturore vibrante tërheq profesionistët, të cilët mund të punësohen nga bizneset e tjera lokale apo të sjellin investime të huaja nga kompanitë që tërhiqen nga talentet e fortë lokalë/ imazhi i përmirësuar.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndikimi i tërthortënë zhvillimin regional përmes ndikimit pozitiv në punësim, inovacion, ndërmarrësi, investime dhe imazhin e territorit / atraktiviteti ▪ Efekshmëri e përmirësuar në modele të qeverisjes për shkak të integritimit horizontal të kulturës në fusha të ndryshme të politikave në mënyrën që kontributi i kulturës në zhvillimin lokal të mund të maksimalizohet.

Për dallim nga mekanizmat e cekur në tabelën më lart, Bakhshi et al. (2013) tregojnë se arti ka ndikim në paga në qytetet e Anglisë. Nëse e shikojmë korrelacionin mes pagesave mesatare në orë dhe punësimit në industrinë e kulturës, duket të ketë korrelacion pozitiv: sa më i lartë niveli i punësimit në sektorin e kulturës, më i lartë është edhe niveli i pagave. Megjithatë, kur autorët shikuan edhe ndryshoret e tjera, siç janë tiparet personale të individit (përvoja, shkathësitë, profesioni), dhe karakteristikat e qytetit (numri i popullatës dhe proporcioni i popullatës me kualifikime të larta), marrëdhënia mes nivelit të pagave dhe punësimit në sektorin e kulturës ndryshon drejtimin: sa më i lartë punësimi në sektorin e kulturës, aq më i ulët është niveli i pagave. Ky raport gjithashtu vlen edhe për një numër institucioneve kulturore: sa më shumë institucione kulturore, pagat janë më të ulëta. Autorët ia atribuojnë këtë fenomen idesë së

diferencialit kompensues. Thënë ndryshe, sa më i madh të jetë numri i institucioneve kulturore dhe niveli më i lartë i punësimit në këtë sektor e bën qytetin më tërheqës dhe rritë cilësinë e jetës në përgjithësi. Për shkak të rritjes së cilësisë së jetës, njerëzit dëshirojnë të vinë dhe jetojnë në qytet me më shumë kulturë dhe art edhe pse me pagë më të ulët me qëllim që të shijojnë pasurinë kulturore të qytetit. Për më tepër, të njëjtat ndryshore (niveli i punësimit dhe numri i institucioneve) shtohen për industritë kreative (industritë komerciale), raporti mbetet i njëjtë për ndryshoret e institucioneve kulturore, por është pozitiv për industrinë kreative, që sugjeron ndikime pozitive të përhapjes nga industria kreative në pjesën tjetër të zonës urbane. Në këtë studim gjithashtu analizohet raporti mes institucioneve kulturore jofitimprurëse dhe industrive kreative dhe konstaton raport pozitiv, duke sugjeruar se ka ndikime domethënëse

pozitive mes sektorit të artit dhe industrive kreative.

Njëstudim tjetër që lidh artin me inovacionet e kanë bërë Rut-Bernshtajn dhe të tjerët (Root-Bernstein et al) (2013). Në këtë studim tentohet të testohen tri hipoteza: 1) Inovatorët ndërmarrës nga fusha e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinieringut dhe Matematikës (ShTIM) angazhohen gjatë jetës së tyre në arte dhe zanate në një shkallë dukshëm më të lartë se një person mesatar, 2) arti ka ndikim pozitiv ekonomik në shkencë dhe teknologji përmes rritjes së masave të inovacionit, 3) Profesionistët e ShTIM-së kuptojnë vlerën e lidhjeve mes artit dhe zanatit me profesionin e tyre. Për të testuar këto hipoteza, autorët përcollën një profesionist ShTIM, i cili kishte diplomuar në Universitetin e Shtetit Miçigan, Universitetin Teknologjik të Miçiganit dhe Universitetin Princeton, si dhe profesionistët, të cilët u janë ndarë fonde të Bashkëpunimit për zhvillim ekonomik të

Miçiganit. Pas krahasimi të këtyre profesionistëve me popullatën e përgjithshme, ata konstatuan se profesionistët e ShTIM-së kanë prej tri deri në dhjetë herëgjasa më të mëdha që të jenë marrë me çfarëdo lloji të artit sesa një amerikan tjetër i rëndomtë. Në studim gjithashtu konstatohet se profesionistët e ShTIM-së të përfshirë në art ka më shumë gjasa të prodhojnë më shumë patenta (të kenë më shumë inovacione), si dhe të jenë më shumë inovativ nga aspekti i ndërmarrësisë. Më pastaj, në kuadër të studimit shikohet edhe historiku familjar për të parë ndikimin e familjeve në inovativitetin e tyre, dhe rezultatet mbesin konsekuente. Në fund, profesionistët e ShTIM-së po ashtu u pyetën nëse vlerësojnë artin e tyre dhe nëse mendojnë se marrja e tyre me art u ka ndihmuar në profesion. Shumica dërrmuese e tyre konfirmojnë rolin pozitiv të artit dhe ua sugjerojnë edhe të tjerëve.

Arti dhe kultura si instrument

Arti dhe kultura gjithashtu janë instrument i mirë dhe i efektshëm në arritjen e qëllimeve të tjera zhvillimore. Duke marrë parasysh mënyrën e tyre unike të depërimit dhe ndikimit tek ndërgjegjja e përgjithshme publike, arti mund të ketë ndikim të fuqishëm në botëkuptimet e individit. Përveç kësaj, ngjarjet kulturore bashkojnë njerëz të profesioneve të ndryshme, të cilët përndryshe vështirë se do të kishin rastin të takoheshin. Takimet e tilla mund të nxisin tolerancën, shumëllojshmërinë dhe kohezionin social. Po ashtu, arti mund të ketë ndikim të fuqishëm në zhvillimin shoqëror dhe emocional, posaçërisht tek të rinjtë. Për shembull, Schellenberg (2011), përmes njëtestimi me metodën e kontrollit të rastësishëm, konstaton se arti ekspresiv mund të ketë efekt të madh në zhvillimin shoqëror dhe emocional të të rinjve, ndërsa në studimin e fundit (2004) ajo konfirmon që trajnimi në muzikë të ketë efekt të njëjtë. Ngjashëm me këtë,

në një testim i kontrolluar dhe sipas përzgjedhjes së rastësishme të bërë në Finlandë, Joronen dhe të tjerët (Joronen et.al.) (2011) konstatojnë se pjesëmarrja në dramë ka zvogëluar numrin e ngacmimeve në shkollë.

Duke konsideruar këtë fuqi të artit, një OJQ e vogël e quajtur Galpão Aplauso, në Rio de Janeiro të Brazilit ka qenë nismëtare e një qasjeje interesante për zvogëlimin e papunësisë në mesin e të rinjve. Brazili ka programe të shumta që kanë për qëllim zvogëlimin e papunësisë tek të rinjtë, siç është subvencionimi i pagave, punësimi i drejtpërdrejtë në sektorin publik, modalitetet fleksibile të punësimit që zvogëlojnë kostot e transaksionit dhe i shmangin obligimet kontingjente të punësimit (duke përfshirë punën në praktikë) dhe shërbimet e sponsoruara të ndërmjetësimit për lloje të ndryshme të programeve të trajnimit dhe aftësisimit profesional. Dëshmitë për efektshmërinë e

këtyre programeve me të vërtetë kanë vërtetuar se disa nga këto programe kanë pasur ndikime pozitive, por të një shtrirje të vogël, ndërsa programet e tjera kanë qenë edhe më pak të efektshme – kështu që, thënë nëpërgjithësi, këto fakte nuk kanë dhënë hapësirë për entuziazëm. Duke i ditur këto rezultate, Galpão Aplauso vendosi të bëjë një eksperiment. Ata krijuan një program, i cili përdor artin ekspresiv dhe teatrin si një mekanizëm pedagogjik dhe krijues tëshkathtësive, ndërsa në ndërkohë janë organizuar edhe aftësime të tjera profesionale. Për të veçuar dhe studiuar efektet e kësaj qasjeje kreative, është krijuar një test i kontrolluar me pjesëmarrës të përzgjedhur sipas rastësisë, përmes të cilit u matën rezultatet e tregut të punës dhe fitimet e pjesëmarrësve, të cilët iu nënshtruan këtij ‘trajtimi’ në krahasim me ata që nuk kaluan nëpër të. Rezultatet tregojnë edhe ndikime afatshkurtra pozitive, gjë e cila ka

qenë e papritur në bazë të studimeve paraprake të ngjashme. Këto ndikime pozitive kanë pasur shtrirje të gjerë, duke shënuar një rritje prej 33.3 për qind në mundësinë e gjetjes së vendit të punës dhe 23.6 për qind rritje në të hyra³.

Ngjashëm me këtë, Palmer (2014) argumenton se artet e bukura dhe ato të aplikuara mund të jenë mekanizëm për zbutjen e varfërisë në Nigeri. Kjo nuk do të thotë eliminim i varfërisë, por shfrytëzimi i arteve të bukura dhe i atyre të aplikuara për t’u ndihmuar posaçërisht grupeve të marginalizuara, siç janë femrat, për t’u bërë më produktive dhe për t’u ndihmuar që të dalin nga varfëria. Programi i sugjeruar është relativisht i thjeshtë dhe ngërthen në vete trajnimin e pjesëmarrësve në artet e bukura dhe ato të

3 Për më shumë informata rreth programit dhe testimit të kontrolluar me pjesëmarrës të përzgjedhur rastësisht, luteni të shihni Calero, et al. (2014).

aplikuara, si dhe parasheh ndihmesën në zbatimin e njohurive të fituara dhe në lirimimin e kreativitetit në prodhimin e tekstilit, poçarisë dhe qeramikës, bizhuterisë (argjendarisë), zanateve të përpunimit të metalit dhe të lëkurës, etj. Duke marrë parasysh se këto produkte vlerësohen shumë, posaçërisht për shkak të origjinalitetit të tyre dhe punimit me dorë, ata po ashtu paraqesin mënyrë për daljen nga varfëria, ndërsa artet e bukura dhe ato të aplikuara paraqesin instrument për rafinimin e shkathtësive të pjesëmarrësve.

Megjithatë, ka shqetësime të rëndësishme që ngritën nga kjo qasje, përmes së cilës promovohet shfrytëzimi i artit si instrument. Shqetësimi kryesor mbështetet në faktin se e thjeshtëzon artin vetëm në një instrument. Pavarësisht se sa i dobishëm është një instrument, vlera e tij gjithmonë varet nga shfrytëzimi dhe më pak konsiderohet si vlerë në vetvete. Andaj, kjo qasje konsideron artin

vetëm si një instrument tjetër të politikave dhe nuk i jep atij vlerë në vetvete. Një shqetësim tjetër është se përmes kësaj qasjeje arti mund të lidhet me çështjet zhvillimore, duke kufizuar kështu dukshëm fushëveprimin e artit—veçanërisht mënyrën se si produktet artistike dhe diskutimet e ndryshme lidhur me to kontribuojnë në formimin e subjektivitetit dhe identitetit sipas Stapëllsit (Stupples, 2014). Për më tepër, shumica e agjencive që shfrytëzojnë artin si instrument, gjithashtu kërkojnë që projekti artistik i tyre të përshtatet me misionin e tyre. Në këtë mënyrë, projektet artistike përfshihen dhe gjykohen në bazë të kritereve të tyre – shpesh kritere të rritjes dhe zhvillimit ekonomik – gjë që më tej kufizon dhe mund të rrezikojë cilësinë dhe subjektivitetin e artit (Stupples, 2014).

Arti dhe zhvillimi ekonomik në kontekstin e Kosovës

Fatkeqësisht, në Kosovë pak punë është bërë, si në aspektin e përgjithësimin të të dhënave, ashtu edhe në atë të studimeve për ta bërë të mundshëm kontekstualizimin e studimeve të lartpërmendura. Në paragrafët e mëposhtëm, do të bëhet një përpjekje për të treguar se si ngjarjet dhe organizatat e ndryshme kulturore mund të kenë ndikuar në rritjen dhe zhvillimin ekonomik, si dhe do të jepen disa sugjerime për atë se si arti dhe kultura mund të shfrytëzohet në stimulimin e niveleve të larta të rritjes dhe zhvillimit. Megjithatë, për shkak të mungesës së të dhënave empirike, këto përpjekje herë pas here do të kenë natyrë më shumë spekuluese, dhe më shumë se shpjegime për ndikimin e organizatave të kulturës dhe artit në ekonomi, ato janë nxitje për studime dhe hulumtime të tjera.

Raporti kryesor i bërë për ndikimin ekonomik të organizatave të kulturës në Kosovë është hartuar nga Instituti GAP (2011). Në këtë raport

shpjegohet ndikimi ekonomik i festivalit të filmit dokumentar dhe atij të shkurtër Dokufest për vitin 2011, si dhe parashihet ndikimi i tij deri në vitin 2014. Në këtë studim, ngjashëm si në raportin e organizatës Americanfor the Arts, përdorët metoda ku të gjitha shpenzimet mblidhen dhe pastaj shumëzohen me multiplikatorin e Kejnshit për të dal deri te ndikimi përfundimtar ekonomik i Dokufestit. Të dhënat janë grumbulluar përmes një ankete të bërë nga Dokufesti – ndoshta të vetmet të dhëna kulturore në dispozicion atëherë. Pas përllogaritjeve, doli që ndikimi ekonomik lokal i Dokufestit në BPV ishte 3.1 milionë €, ndërsa në bazë të parashikimeve kjo shifër pritet të jetë 21.9 milionë euro për katër vitet e ardhshme.

Përveç ndikimit ekonomik të shpenzimeve të festivalit, ekzistojnë edhe një numër efektesh të tjera pozitive që Dokufesti mund të ketë në ekonominë e Kosovës. Së pari, në kuptimin e teorisë së bazës

së eksportit, ky festival tërheq një numër të madh të vizitorëve të huaj. Në bazë të të dhënave të festivalit, në vitin 2013 ky festival është vizituar nga afro 10000 vizitorë, nga të cilët përafërsisht 23% kanë qenë të huaj (Çeku, 2014). Këta vizitorë shpenzojnë në ushqim, hotele dhe në mallra e shërbime të tjera, gjë e cila e zhvillon ekonominë lokale. Me fjalë të tjera, njëri nga ndikimet e festivalit është rritja e numrit të turistëve dhe pasurimi i ofertës së përgjithshme turistike të Kosovës. Për ta përkrahur numrin në rritje të turistëve, sektori i shërbimeve duhet të zgjerohet dhe t'i përmirësojë shërbimet e veta. Në rastin e Prizrenit, qytetit nikoqir të Dokufestit, zgjerimi i sektorit të shërbimeve ka rezultuar me hapjen e shumë bujtinave që ofrojnë shërbime hoteliere, të cilat plotësojnë hotelet dhe kapacitetet e tyre në rritje. Ky ndryshim drejtpërdrejtë ndikon në rritjen e mirëqenies së ekonomike të amvisërive.

Gjithashtu mund të argumentohet se në një shkallë të caktuar Dokufesti ka ndryshuar modelin e konsumit të popullatës lokale, si dhe shijet dhe preferencat e tyre për mallrat dhe shërbimet vendore. Duke përkujtuar argumentin e Markusenit dhe të tjerëve (Markusen, et al.), ky ndryshim i modelit të konsumit do të mund të luante rol domethënës në rritjen e punësimit – që është ndër problemet themelore për ekonominë e Kosovës. Tani që dokumentarët dhe filmat e shkurtër janë në dispozicion gjatë festivalit, konsumi do të mund të drejtohet kah prodhimet dhe shërbimet vendore dhe jo në atë të importuara. Për më tepër, dhe prapë duke rikujtuar argumentin e Markusen et al., konsumi lokal mund të ketë nxitur inovacionin. Në fakt, Dokufesti duket se ka frymëzuar një numër të madh të festivaleve të tjera në mbarë Kosovën, siç është festivali NGOM, festivali Anibar, Komedia Fest, Sculpfest, etj. Këto festiva-

le në vetvete janë bërë ngjarje të rëndësishme kulturore. Për shembull, NGOM fest, festival ky i muzikës i organizuar gjithashtu në Prizren, në vitin 2013 ka pasur 6000 vizitorë (Çeku, 2014). Është interesant se një numër i madh festivalesh organizohen në Prizren që mund të nënkupton krijimin e një 'klase kreative' apo të një kllasterikulturor atje.

Një ndikim tjetër i mundshëm dhe i rëndësishëm, nëse kujtojmë argumentin e Markizit (Marquis) mund të ishte varshmëria pozitive e popullatës lokale ndaja artit, gjë e cila rritë konsumin e përgjithshëm të mallrave dhe shërbimeve artistike. Fakti që festivali po rritet prej vitit në vit tregon kërkesën në rritje për dokumentarë dhe filma të shkurtër, që mund të jetë rezultat i vlerësimit të rritur për ta dhe, rrjedhimisht, i konsumit të rritur të tyre. Përveç rritjes së Dokufestit, po ashtu shënohet rritje edhe e festivaleve të tjera të filmit, siç janë Skena Up, 9/11 dhe Anibar, gjë e

cila prapë mund të nënkupton një vlerësim më të lartë dhe konsum më të madh.

Një efekt tjetër pozitiv i Dokufestit mund të jetë edhe pasqyrimi i tij në një dritë shumë pozitive në mediet botërore. Festivali është paraqitur në medie të shumta dhe të famshme ndërkombëtare, duke përfshirë BritishIndependent dhe Guardian, Reuters, Huffington Post, etj. Raportet e tilla të medieve ndërkombëtare natyrisht se kanë efekt pozitiv në imazhin dhe reputacionin e Kosovës. Në krahasim me këtë, në vitin 2009 Qeveria e Kosovës filloi fushatën "Kosovo the Young Europeans" (Kosova – evropianët e rinj) në gjashtë transmetuesit më të mëdhenj botëror si mënyrë për të përmirësuar imazhin e Kosovës në botë. Kjo fushatë kushtoi 5.7 milionë euro, ndërsa efektet e saj kanë qenë të kufizuara (Preportr, 2012). Një fushatë tjetër është bërë në vitin 2012, e cila kushtoi 1 milionë euro vetëm për të reklamuar në CNN.

Efektet e saj janë të diskutueshme, posaçërisht nëse konsiderojmë faktin se në atë reklamë monumenti i NEWBORN-it disi doli si NEWPORN, gjë e cila shkaktoi reagime të shumta të medieeve. Nëse i krahasojmë këto shpenzime të Qeverisë së Kosovës dhe shpenzimet për Dokufest, del se në vitin 2013 për Dokufestin Qeveria ka dhënë vetëm 20,000 euro.

Ndikimet e mundshme të Dokufestit janë analizuar për shkak të madhësisë së festivalit dhe të efekteve më të dukshme që ka, pasi që mungojnë të dhënat për të analizuar efektet e tij më delikate. E njëjta vlen edhe për organizime të tjera kulturore, edhe pse fushëveprimi i efekteve ndryshon prej organizatës në organizatë. Së këndejmi, ia vlen të theksohen ndikimet të ngjarjeve apo të mirave të tjera kulturore. Thënë në përgjithësi, ka pasur performanca dhe të mira të shumta kulturore ku janë trajtuar çështjet sociale. Për shembull, Haveit, një grup

ky i artistëve performues, vazhdimisht kanë trajtuar çështje të rëndësishme sociale dhe përmes performancave të tyre kanë inkurajuar debatin dhe rrjedhimisht kanë rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për këto çështje. Ngjashëm me këtë, shumë motive të prodhuara në Kosovë kanë bërë të njëjtën gjë. Filmi “Heroi”, ku trajtohet çështja e varfërisë dhe mungesa e kujdesit institucional për veteranët e luftës; “Tri Dritaredhenjë varje”, ku trajtohet çështja e viktimave të dhunimit gjatë luftës, kanë rritur ndërgjegjësimin për këto çështje. Ngjarjet e tjera kulturore, siç është Tour De Kosovo, një xhiro kjo rreth një numri të vendeve të trashëgimisë kulturore përreth Kosovës kanë mundur të kontribuojnë në rritjen e kohezionit social dhe të tolerancës, dhe kanë mundur të kultivojnë diversitetin përmes një vetëdijesimi të rritur për historinë dhe diversitetin e trashëgimisë kulturore. Ngjashëm me këtë, GreenFest, festival ky i muzikës i

organizuar në Mitrovicën e ndarë etnikisht, ka mundur të bëjë të njëjtën gjë, duke bashkuar audiencë të etnive të ndryshme dhe duke inkurajuar vlerat e përbashkëta.

Çështjet mundshme të tjera për artin në Kosovë

Një studim i bërë nga Instituti Riinvest(2011) përfshiu një grup të fokusit prej gjashtë pjesëmarrësish me qëllim të të kuptuarit të perceptimeve dhe të sjelljeve të konsumatorëve kosovarë lidhur me konsumin e verës. Fillimisht atyre iu parashtrua pyetja lidhur me mendimin e tyre për produktet vendore të verës. Pjesëmarrësit kanë identifikuar konsekuencën e cilësisë së verës, standardizimin, cilinë e dobët, mungesën e kthjelltësisë, paketimin, etiketimin dhe brandimin si pengesa kryesore për zhvillimin e produkteve vendore të verës. Më pastaj, nga pjesëmarrësit kërkua që t' shijojnë gjashtë lloje të verërave vendore dhe të huaja pa e ditur se cilin lloj po e pinin. Nga ky degustim doli të jetë vera vendore si më e vlerësuar. Në këtë studim theksohet nevojja për përmirësimin e paketimit, etiketimit dhe brendimit të verës kosovare për shkak të ndikimit të madh që këta faktorë kanë në shije. Në përgjithësi, produktet

e Kosovës kanë nevojë për më shumë përmirësime në brandim dhe paketim sesa në cilësi. Kjo nuk nënkupton se cilësia e produkteve nuk ka nevojë për përmirësim, por se më shumë rëndësi duhet t'i kushtohet krijimit të brendit. Sektori i verës i shtjelluar në studimin e lartcekur është vetëm njëri prej sektorëve që lëngon nga mungesa e brendit dhe paketimit cilësor.

Duke marrë parasysh ndikimet pozitive të artit në industritë kreative (siç janë agjencitë reklamuese, të dizajnit, etj), siç është ilustruar në studimet e lartcekura, arti në Kosovë do të mund të stimulohet edhe më tej si një mekanizëm për përmirësimin e brendeve vendore, të paketimit të tyre dhe dizajnit në përgjithësi. Natyrisht, arti dhe kultura nuk do të jenë zgjidhja e vetme, mirëpo ato kanë potencialin që të japin kontribut të dukshëm pozitiv në këtë aspekt.

Për më tepër, duke marrë parasysh efektin e rëndësishëm që arti ka

në paga dhe kontributin e tyre në idenë e diferencialit kompensues, siç është paraqitur në studimin e Bakhshi et al., arti mund të ketë ndikim të rëndësishëm në trajtimin e çështjes gjithnjë e më problematike të migrimit ilegal. Nëse supozojmë se shkaqet kryesore të migrimit janë vështirësitë ekonomike dhe cilësia e dobët e jetesës në Kosovë, arti mund të jetë faktor i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së jetës dhe, rrjedhimisht, në tërheqjen e njerëzve që të punojnë edhe për paga më të ulëta. Duke parandaluar migrimin, më shumë njerëz do të jenë në gjendje t'i kontribuojnë ekonomisë së Kosovës dhe ndoshta edhe për paga më të ulëta, gjë e cila i jep ekonomisë së Kosovës një përparësi. Po kështu, më shumë njerëz do të thotë më shumë tatime, që nga ana tjetër do të thotë më shumë zhvillim dhe projekte kapitale. Prapë, siç ishte rasti me brendet, nuk duhet të pritët që kultura të jetë e vetmja zgjidhje, por natyrisht se mund të

luajë rol të rëndësishëm.

Dhe në fund, siç është treguar nga organizata Americans for the Arts, kultura është degë që kërkon angazhim të fuqisë së madhe punëtore, që mund të shkojë edhe deri në 30%, ndërsa tek të rinjtë edhe më shumë. Pra, më shumë investime në art do të mund të çonin në zvogëlimin e papunësisë. Për më tepër, siç argumentojnë Markusen et al., efekti i multiplikatorit për artin është shumë më i madh për shkak të faktit se artistët kanë tendenca të shpenzojnë më shumë lokalisht, duke i bërë kështu fondet e harxhuara edhe më të efektshme në zvogëlimin e papunësisë. Po ashtu, siç tregojnë Piergiovanni, et al., industritë kreative ofrojnë më shumë rritje të punësimit se sa sektorët e tjerë tradicionalë. Kështu, duke marrë parasysh lidhjen e ngushtë të artit dhe sektorëve kreativë, arti paraqet mënyrën për luftimin e papunësisë në Kosovë.

Përfundim

Thuhet se fizikani i famshëm Albert Ajnshtajn (Albert Einstein) ka thënë: “Secili është gjeni, por nëse e gjykoni peshkun për nga aftësia e ngjitjes në një pemë, do të kalojë tërë jetën e tij duke menduar se është budalla”. Deri më tani arti dhe kultura vazhdimisht janë gjykuar në këtë mënyrë, ashtu siç janë gjykuar edhe industritë e tjera – pra, për nga aftësia e tyre e prodhimit, punësimit, eksportit, taktiveve dhe kështu me radhë. Nëse matet në këtë mënyrë, është e vërtetë se arti dhe kultura nuk kanë shumë efekt në ekonomi. Eksportet nga fusha e kulturës janë cikërrime nëse krahasohen me eksportet e sektorëve të tjerë. Nga ana tjetër, nëse konsiderohen thjesht si një mall apo e mirë konsumi, dhe jo si kontribut në kapitalin kulturor apo si mall a e mirë kapitale, arti dhe kultura janë të dënuar të cilësohen si mallra dhe shërbime, për të cilat politikëbërësit nuk duhet të shqetësohen. Në shumë raste, duke përdorur analogjinë e

Ajnshtajnit, arti e ka kaluar jetën duke besuar se është budalla, nëse flasim nga aspekti ekonomik.

Megjithatë, hulumtimet gjithnjë e më shumë po tregojnë efektet pozitive të artit në ekonomi. Në këtë dokument të politikave, janë përmbledhur disa studime, ku argumentohen dhe tregohen mënyra të shumta, përmes të cilave arti dhe kultura ndikojnë pozitivisht në zhvillimin dhe rritjen ekonomike. Përveç kësaj, janë përmbledhur edhe argumentet tradicionale se si janë konsideruar arti dhe kultura, për shkak të faktit se shumica e këtyre argumenteve vazhdojnë të jenë aktuale edhe sot e kësaj dite.

Në fund mund të themi se është tentuar që këto studime të futen në kontekstin e Kosovës. Fatkeqësisht për shkak të mungesës së të dhënave empirike, përpjekjet për të interpretuar kontekstin e Kosovës nën dritën e studimeve të përmbledhura në këtë dokument politikash, nganjëherë kanë qenë

më shumë të natyrës spekulative dhe më shumë se sa të shpjegojnë ndikimin e organizatave të kulturës dhe artit në ekonomi kanë pasur për qëllim krijimin e një traseje për hulumtime dhe studime të tjera. Pavarësisht mungesës së të dhënave, ka ndikime të qarta pozitive të disa ngjarjeve kulturore që shkojnë përtej shifrave të thjeshta të shpenzimeve dhe kontributit të drejtpërdrejtë në BPV. Këto ndikime ishin frymëzimet që dha Dokufesti për festivalet e tjera që kanë lulëzuar, si dhe për një kërkesë të rritur për dokumentarë, filma të shkurtër dhe të metrazhit të gjatë përmes vlerësimit të këtyre të mirave apo mallrave dhe varësisë pozitive ndaj tyre. Fare në fund mund të themi se arti do të mund të ndihmonte në trajtimin e disa çështjeve imediate ekonomike në Kosovë. Këto çështje përfshijnë migrimin, brendimin vendor dhe papunësinë.

Punimet e cituara

Americans for the Arts, 2013. Arts & Economic Prosperity IV, Washington D.C.: Americans for the Arts.

Bakhshi, H., Lee, N. & Mateos-Garcia, J., 2013. Capital of Culture? An Econometric Analysis of the Relationship between Arts and Cultural Clusters, Wages, and the Creative Economy in English Cities. In: M. Rushton, ed. Creative Communities: Art Works in Economic Development. Washington D.C. : Brookings Institute.

Bucci, A., Sacco, P. L. & Segre, G., 2014. Smart endogenous growth: cultural capital and the creative use of skills. International Journal of Manpower, 35(1).

Calero, C. et al., 2014. Can Arts-Based Interventions Enhance Labor Market Outcomes among Youth? Evidence from a Randomized Trial in Rio de Janeiro. The Institute for the Study of Labor.

Çeku, H., 2014. Profili i Sektorit të Turizmit, s.l.: Ministria e Tregëtisë

dhe Industrisë.

Cooke, P. & De Propris, L., 2011. A policy agenda for EU smart growth: the role of creative and cultural industries. Policy Studies, 32(4).

Creative Spin, 2012. Creative Spillovers for Innovation: URBACT II Thematic Network BASELINE STUDY, s.l.: s.n.

Department of Culture, Media and Sport, 2010. Creative industries economic estimates, London: Department of Culture, Media and Sport.

GAP Institute, 2011. Economic Impact of Dokufest, s.l.: GAP Institute.

Joronen, K., Konu, A., Rankin, S. & Astedt-Kurki, P., 2011. An evaluation of a drama program to enhance social relationships and anti-bullying at elementary school: a controlled study. Health Promotion International, 27(1).

Markusen, A., Gadwa Nicodemus, A. & Barbour, E., 2013. The arts,

consumption, and innovation in regional development. In: M. Rushton, ed. *Creative Communities: Art Works in Economic Development*. Washington D.C.: Brookings Institution.

Marquis, M., 2013. *Bringing Culture to Macroeconomics*. *Atlantic Economic Journal* .

Palmer, F. M., 2014. Reformative role of Fine and Applied Arts education in the alleviation of poverty, promotion of self-reliance and national development in Nigeria. *Journal of Visual Art Practice*, 13(2).

Pedroni, P. & Sheppard, S., 2013. *The Economic Consequences of Cultural Spending*. In: M. Rushton, ed. *Creative Communities: Art Works in Economic Development*. Washington D.C.: Brookings Institution.

Piergiovanni, R., Carree, M. & Santarelli, E., 2012. Creative industries, new business formation, and regional economic growth. *Small Business Economics*.

Pozhegu, D., 2014. *Politikat Kulturore dhe Ndarja Buxhetore për Kulturën në Kosovë*, Prishtina: Forumi Kulturor.

Preportr, 2012. *Imazhi pa hesap i Republikës*, s.l.: s.n.

Root-Bernstein, R. et al., 2013. *Arts, Crafts, and STEM Innovation: A Network Approach to Understanding the Creative Knowledge Economy*. In: M. Rushton, ed. *Smart endogenous growth: cultural capital and the creative use of skills*. Washington D.C.: Brookings Institution .

Rosenfeld, S., 2005. *The Art of Economic Development* , s.l.: Regional Technology Strategies, Inc..

Rushton, M., 2004. *Culture and Public Finance*. *Public Finance and Management*.

Rushton, M., 2013. Introduction. In: M. Rushton, ed. *Creative Communities: Art Works in Economic Development*. Washington DC: Brookings Institution.

Schellenberg, E. G., 2004. Music lessons enhance IQ.. Psychological Science.

Schellenberg, E. G., 2011. Examining the association between music lessons and intelligence. British Journal of Psychology.

Stupples, P., 2014. Creative contributions: The role of the arts and the cultural sector in development. Progress in Development Studies, 14(2).

The National Governors Association , 2012. Arts & the Economy: Using Arts and Culture to Stimulate Economic Development, Washington D.C.: Center for Best Practices.

Throsby, D., 2008. Modelling the cultural industries. International Journal of Cultural Policy, 14(3).

Travel Industry Association, 2003. The Historic/Cultural Traveler, s.l.: s.n.

www.forumikulturor.net



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë



Implementuar nga:





forumikulturor.net
facebook.com/ForumiKulturor
twitter.com/forumikulturor